REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 355 Prot. Tiranë, më 13.03.2019

VENDIM Nr. 41, datë 06.03.2019

Në mbështetje të ***Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 134,*** Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, datë 06.03.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "Ndërtim rrjeti inxhinjerik telefonik me Fibra optike dhe Coax" Bashkia Sarandë*** -subjekti "ATC CABLE" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "Ndërtim rrjeti inxhinjerik telefonik me Fibra optike dhe Coax" Bashkia Sarandë*** -subjekti "ATC CABLE" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.

2. Subjekti "ATC CABLE" sh.p.k duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje katër palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji dhe DRKK Vlorë, të cilët duhet të ndjekin në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtim rrjeti inxhinjerik telefonik me Fibra optike dhe Coax" Bashkia Sarandë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë ato.

3. Pas lidhjes së akt-marrëveshjes së sipërpërmendur, të vijojë procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore dhe pas paisjes me lejen përkatëse, të fillojnë punimet e gërmimit, të cilat do realizohen sipas akt-marrëveshje katër palëshe të cituar në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Në rrugën "Onhezmi" në pozicionet e pusetave, subjekti i licencuar në arkeologji të kryejë dokumentimin stratigrafik të shtresave, i cili duhet të depozitohet pranë ASHA.

5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: *sekretaria.kka@asha.gov.al*
Website: asha.gov.al

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTER

SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: *sekretaria.kka@asha.gov.al*
Website: asha.gov.al